

5. Shumësi i grupit emëror *magjistari i ëndrrës*, është: 1 pikë
- A) magjistar të ëndrrave.  
 B) magjistarët e ëndrrave.  
 C) magjistarë të ëndërrave.  
 D) magjistar të ëndërrave.
6. Në fjalinë: "*Që femijë babai më ka mahnitur me dashurinë për librat.*", folja e nënvizuar është në: 1 pikë
- A) kohën e kryer.  
 B) kohën e tashme.  
 C) kohën e ardhme.  
 D) kohën e kryer të thjeshtë.
7. Cila nga fjalitë e mëposhtme është e thjeshtë? 1 pikë
- A) Të kapësh shpejt atë që nuk shkon.  
 B) Përveç kësaj ka edhe burime digjitale si podcast.  
 C) Jeta ka momente kur njeriu tërhiqet për t'u rishfaqur sërish.  
 D) Në dhomën time kudo kam vendosur citime që më bëjnë të buzëqesh.
8. Në fjalinë: "*Ndërkohë kurrë nuk kam nënvlerësuar fuqinë e një filmi të bukur frymëzues.*", fjala e nënvizuar është: 1 pikë
- A) përcaktor.  
 B) rrethanor.  
 C) kundrinor i drejtë.  
 D) kundrinor i zhdrejtë.
9. Fjala e nënvizuar në fjalinë: "*Gjithmonë e gjej frymëzimin tim.*", është: 1 pikë
- A) nyje.  
 B) lidhëz.  
 C) përemër lidhor.  
 D) trajtë e shkurtër.
10. Fjala *kokëfortë* në fjalinë: "*Realiteti është kokëfortë dhe duhet ta shohesh në sy.*", është fjalë: 1 pikë
- A) e prejardhur.  
 B) e përngjitur.  
 C) e përbërë.  
 D) e parme.
11. Në fjalinë: "*Mund të sjellim ndër mend Princin e vogël*", gjeni kundrinorin. Përcaktoni llojin e tij dhe tregoni me se është shprehur. 3 pikë
- Kundrinori: \_\_\_\_\_
- Lloji: \_\_\_\_\_
- Me se është shprehur: \_\_\_\_\_
12. Zbuloni formën e pashtjelluar foljore të përdorur në fjalinë e dhënë dhe përcaktoni llojin: "Kam informacion të gjerë mbi librat për të ndihmuar veten." 2 pikë
- Forma e pashtjelluar foljore: \_\_\_\_\_
- Lloji: \_\_\_\_\_
13. Zbuloni dy karakteristika gjuhësore të këtij teksti. Ilustrojeni ato me shembuj. 4 pikë
- Karakteristika 1: \_\_\_\_\_
- Shembulli nga teksti: \_\_\_\_\_
- Karakteristika 2: \_\_\_\_\_
- Shembulli nga teksti: \_\_\_\_\_

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi dhe gjimnazi gjjuhësor) 1 pikë

14. Për cilën arsye, sipas mëfimitarit, në momente përfundimtare njeriu jo gjithmonë i gjen zgjidhjet në libra e filma?

1 pikë

15. Në fjalinë e mëposhtme gjeni gjymtyrët homogjene.  
Ai për mua është si hartë gazmore për botën, njerëzit dhe problematikat.

Gjymtyrët homogjene:

3 pikë

16. Renditni dy nga burimet e frymëzimit të mëfimitarit dhe shpjegoni përse i shërbojnë atij këto burime?

Burimet:

Shpjegimi:

17. Analizoni shprehjen: "Te ringrihesh si Sizifi, me forcë dhe ngulmim, me dashuri për jetën dhe me një model të qartë e motivues."

2 pikë

## PJESA II

Në këtë fragment jepet Xha Gorioi i cili jeton i braktisur nga të bijat në pensionin e zonjes Voker. Ato vijne ta takojnë të atin vetëm për interes, kur duan t'i zhvatën atij paratë deri në qindarkën e fundit. Ky është një nga këto momente. Anastasia, vajza e tij e madhe ka ardhur t'i kërkojë Xha Gorioit para për të paguar fustanin me të cilin do të shkojë në ballo. Xha Gorioi është i gatshëm të japë edhe jetën për të plotësuar çdo teke të saj.

Honore de Balzac

Xha Gorioi

- U shkunda! - tha duke shkukur flokët. - Ah, sikur ta dija se ku do të shkoja të vidhja, po është zor edhe të gjesh një çast të tillë. Pastaj, duhen njerëz dhe kohë për të grabitur bankën. Oh, duhet të vdes, vetëm vdekja i lan hallet! S'jam më i zoti për asgjë, s'jam më baba, jo. Ajo më kërkon, ka nevojë! Dhe unë, varfanjaku, s'kam asnjë dysh. Ah, ti sigurove për vete të ardhura jetike, o i mallkuar dhe nuk mendove për vajzat! Domethënë nuk i do ato? Ngordh, ngordh si qen që je! Po unë jam më i lig se qeni, qeni nuk do të sillej kështu! Oh! Koka po më zien!

\*\*\*

E shikoni, pata fuqi t'u bëj ballë të gjithave, po këtë herën e fundit që u ndodha pa para, m'u dërrmua zemra. Oh! Oh! S'ia bëra as një, as dy, po u vasha e u splitullova dhe dola shita për gjashtëqind franga servisit e bukës dhe ca togëza argjendi, pastaj lashë peng për një vit të ardhurat e mia jetike kundrejt katërqind frangave që mora në dorë nga xha Gobseku. S'ka gjë! Do të ha bukë thatë! Ajo më mjaftonte kur isha i ri, do të më mjaftojë edhe tani. Kështu që Nasia ime do të kalojë një mbremje të mirë. Do të vishet për mrekulli. Këtu nën jastëk janë të një mijë frangat. Më bëhet zemra mal që i kam këtu nën tokë ato që do ta gëzojnë Nasinë e gjerë. Nesër do të jem mirë. Nasia do të vijë në ora dhjetë. Nuk dua të më gjejnë të emurë vajzat, se pastaj nuk do të shkojnë fare në ballo, po do të rrinë të përkujdesen për mua. Nasia do të më përqafojë esër si fëmijën e saj, përkëdheljet e saj do të më shërojnë. A nuk do t'i kisha shpenzuar te farmacisti një mijë franga për amat? Më mirë t'ia jap asaj që m'i shëron të gjitha sëmundjet, Nasisë sime. Do ta ngushëlloj në mjerimin e saj të paktën, atëherë kështu mund ta laj fajin që bëra duke siguruar për vete një të ardhur jetike. Ajo ka rënë në fund të greminës dhe unë jam më i zoti ta nxjerr.

\*\*\*

aloshi ishte i pikëlluar, kur u takua me Delfinën dhe e gjeti atë të krehur, me këpucët e vallëzimit dhe nuk i mbetej veçse të hte fustanin e ballos. Po tamam si ato penelatat që u japin piktorët tablove të tyre në mbarim e sipër, përgatitjet e fundit konin më tepër kohë nga ç'kërkonte vetë sfondi i pëlhurës.

! Nuk jeni veshur? - i tha ajo.

nië, po ati iuaj

- Prapë im atë! - I thiri ajo duke i prerë fjalën. - Nuk do të m'i mësoni ju detyrimet e mia kundrejt im eti. Unë e njëj prej ç'fatkeqësi e madhe na kanoset? Vetëm se ne e fronditëm pak sot në mëngjes. Janë në rrezik pasuritë tona, e kupton se - Zonjë ...

- Shkoni! Asnjë fjalë, - tha ajo, duke rendur në dhomën e vogël që të merrte gjerdanin.

- Po shkoni, pra zoti Eugjen! Do ta zemëroni zonjën, - tha Tereza, duke e shtyrë lehtë djalosin, të tmerruar nga kjo atvrasje elegante. Ai shkoi të víshej i kredhur në mendimet më të trishtuara e më dekurajuese.

E shikonte botën si një oqean me llum, ku njeriu do të zhytej gjër në grykë, posa të vinte pak këmbën. "Aty kryhen vetëm krime meskine!" - tha me vete.

18. Romani *"Xha Gario"* është cilësuar si:

1 pikë

- A) roman social.
- B) roman filozofik.
- C) roman historik.
- D) roman psikologjik.

19. Vepra e Balzakit i përket letërsisë:

1 pikë

- A) realiste.
- B) klasiciste.
- C) humaniste.
- D) romantike.

20. Personazhet e Balzakit shfaqen si:

1 pikë

- A) zëdhënës të ideve dhe ndjenjave të autorit.
- B) personazhe reale me të gjitha veset dhe virtytet e tyre.
- C) personazhe të lindura për pasione e bëma të mëdha.
- D) figura skematike, abstrakte që lëvizin brenda skemave të ngurta

21. Në cilën nga alternativat e mëposhtme mbiemri është përdorur në kuptim të figurshëm?

1 pikë

- A) Dhomë e vogël.
- B) Djalosh i pikëlluar.
- C) Përgatitjet e fundit.
- D) Fatkeqësi e madhe.

22. Cili është kuptimi i fjalës *u shkunda* në fjalinë e mëposhtme?

1 pikë

- U shkunda! - tha duke shkukur flokët.*
- A) U mërzi.
  - B) U tremba.
  - C) U varfërova.
  - D) Hoqa pluhurin.

23. Në cilin nga pohimet e mëposhtme zbulohet pushteti i pakufishëm i parasë?

1 pikë

- A) Janë në rrezik pasuritë tona, e kupton se ç'fatkeqësi e madhe na kanoset?
- B) Pastaj, duhen njerëz dhe kohë për të grabitur bankën.
- C) Këtu nën jastëk janë të një mijë frangat.
- D) Dhe unë varfanjaku, s'kam asnjë dysh.

24. Cila është figura stilistike që përftohet në fjalinë: *"Po tamam si ato penelat që u japin piktorët tablove të tyre në mbarim sipër."*?

1 pikë

- A) Epiteti.
- B) Metafora.
- C) Similituda.
- D) Personifikimi.

25. Veçori e stilit të Balzakit është:

1 pikë

- A) përshkrimi proliks i hollësishëm dhe me detaje.
- B) përshkrimi i ngjarjeve me objektivitet shkencor.

1 pikë

26. Plaku Gorio është i gatshëm të vdesë sepse:

- A) Delfina është e sëmurë.
- B) Anastasisë i duhen para për fustan.
- C) Anastasia do të ndahet nga bashkëshorti.
- D) vajzat e tij nuk janë bashkëshorte besnike.

1 pikë

27. Rastinjaku u dëshpërua nga fjalët e Delfinës, sepse:

- A) kuptoi se ajo ishte një njeri pa ndjenja.
- B) kuptoi se ajo nuk e respektonte mendimin e tij.
- C) kuptoi se ajo dashuronte zotën e Nysingen.
- D) kuptoi se ajo nuk do ta shoqëronte në ballo.

28. Xha Gorioi vuan nga pasioni mbizotërues për të bijat.

- a) Ilustrojeni këtë pasion me dy shembuj nga fragmenti.

2 pikë

---



---

- b) Analizoni gjendjen shpirtërore të Gorioit në fragment.

2 pikë

---



---

29. Cila është figura stilistike që përdor plaku Gorio për të portretizuar veten në pjesën e parë?

1 pikë

---



---

30. Shpjegoni kontrastin që krijohet nga fjalët e Gorioit.

*Do të ha bukë thatë!*

*Keshtu që Nasia ime do të kalojë një mbremje të mirë.*

2 pikë

---



---

31. Në pjesën e dytë Gorioi fajëson veten në lidhje me vajzat e tij. Cili është fajti? A mendoni edhe ju se kemi të bëjmë me një faj? Jepni një argument mbështetës për përgjigjen tuaj.

2 pikë

---



---

32. Komentoni shprehjen: *atvrasje elegante.*

2 pikë

---



---

33. Dialogu në fundin e fragmentit nxjerr në pah karakteret e personazheve.

- a) Krahasoni figurën e Delfinës dhe Rastinjakut nisur nga ky dialog.

2 pikë

---



---

- b) Identifikoni ndjesinë e Rastinjakut.

1 pikë

---



---

Fjala e fundit në fragment dëshmon forcën përgjithësuese të Balzakut. Ç'filozofi të kohës shpreh ajo?

2 pikë

## Pjesa III

35. Shkruani një ese argumentuese për temën:  
*Unë asnjëherë nuk heq dorë nga diçka. Gjithmonë e gjej frymëzimin për të vazhduar. Frymëzimi im është dashuria për jetën.*

8 pike

Shtjellimi i idesë (35 a)	Organizimi dhe struktura (35 b)	Stili dhe originaliteti (35 c)	Saktësia gjuhësore (35 d)	Totali 35
2 pike	2 pike	2 pike	2 pike	8 pike

**PJESA I**

**Çfarë më frymëzon!**

Në fjalimin para shkollës me rastin e diplomimit tim, ndër të tjera unë rrëfeva edhe për frymëzimin si pjesë e dashurisë për veten, përmes së cilës, ne zbulojmë jo vetëm anën tonë më të mirë, por dëshmojmë edhe madhështinë tonë si njerëz.

Ne duam të tregojmë se kush na frymëzon. Pozitiviteti im e ka burimin nga im atë. Ai është këshilluesi dhe shpesh edhe magjistari i ëndrës sime. Që fëmijë babai më ka mahnitur me dashurinë për librat. Një ditë m'u shpreh: - Te librat do të gjesh jo vetëm shijen e së bukurës, jo vetëm kuriozitetin mbi zbulimin e botës shpirtërore, por edhe shembuj për jetën dhe çelësin për zgjidhjen e shumë problemeve.

Frymëzimi mbi të gjitha më mban të angazhuar dhe optimist. Sot, ndonëse ka shumë mënyra motivimi, libri ende është Frymëzimi im më i mirë. Kam informacion të gjerë mbi librat, revistat apo romanel motivues për të ndihmuar veten. Mund të sjellim ndër mend "Princin e vogël" të Antoine de Saint-Exupery. Ai për mua është si hartë gazmore dhe në të njëjtën kohë serioze për botën, njerëzit dhe problematikat.

Përveç kësaj ka edhe burime digjitale si podcast\*. Ndërkohë kurë nuk kam nënvlerësuar fuqinë e një filmi të bukur frymëzues. Good Will Hunting (1997) është një i tillë me aktorët e famshëm Matt Damon, Robin Williams, Ben Affleck. Përmes tij përjetoj fuqinë e dëshirës për arsimim dhe mënyrën se si e zbulon këtë gjë personazhi kryesor.

Ndonjëherë jeta ka momente përhumbëse, kur njeriu tërhiqet për t'u rishfaqur sërish. Kjo ndodh kur humbet në një betejë, në një biznes, njerëz të dashur, një ëndërr. Kjo ndodh pasi jo gjithmonë ajo që lexon në një libër, film apo udhëzues është e mjaftueshme. Realiteti është më kokëfortë dhe duhet ta shohësh në sy, të kapësh shpejt atë që nuk shkon, dhe pas një pauze të domosdoshme të ringrihesh.

Po po, të ringrihesh si Sizifi, me forcë dhe ngulmim, me dashuri për jetën dhe me një model të qartë e motivues.

Fokusimi duhet të jetë në përgjigjet që merr për pikëpyetje të ndryshme, të cilat të çojnë te fitorja. Kjo është ajo që unë e quaj vazhdimësi. Personat që ringrihen janë ata që nuk dyshojnë në aftësitë e tyre dhe nuk bien në "pus emocional". Ata e dinë se përjetimet negative janë të dëmshme.

Në dhomën time kudo kam vendosur citime që më bëjnë të buzëqesh si: kushdo që ka arritur gjëra pozitive në jetë, ka kaluar sfida, por ato janë përfundimtare vetëm kur heq dorë.

Unë asnjëherë nuk heq dorë nga diçka. Gjithmonë e gjej frymëzimin tim. Frymëzimi im është dashuria për jetën.

*Pjesë nga ditari i një nxënësi*

\*Podcast është një formë e medias digjitale që përbehet nga një seri episodesh në format audio, video etj.

- 1. Një nga mesazhet që përcjell teksti është: 1 pikë
  - A) librat, filmat, revistat nuk janë burim optimizmi.
  - B) burimi i optimizmit tek njeriu është frymëzimi.
  - C) përvoja prindërore është i vetmi model frymëzimi.
  - D) njeriu frymëzohet vetëm nga dashuria për të tjerët.
  
- 2. Cila është gjuha e përdorur në këtë tekst? 1 pikë
  - A) Gjuhë joformale e afërt me gjuhën e komunikimit të përditshëm.
  - B) Gjuhë teknike dhe e drejtpërdrejtë.
  - C) Gjuhë informuese - objektive.
  - D) Gjuhë analitike - objektive.
  
- 3. Sipas babait të rrëfyesit në libra gjen: 1 pikë
  - A) vetëm shijen e së bukurës.
  - B) vetëm çelësin për të zbuluar botën.
  - C) modele të ngurtësuar personazhesh.
  - D) çelësin e zgjidhjes për shumë probleme.
  
- 4. \*Në fjalinë: "Unë rrëfeva edhe për frymëzimin si pjesë e dashurisë për veten.", fjala e nënvizuar është: 1 pikë
  - A) përemër vector.
  - B) përemër dëftor.